



Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo



KOMPAKNA KOSOVARE PËR DISTRIBIM DHE FURNITIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEIVANJE ELEKTRIKOM ENERGIJOM D.O.O.

KEDS - SH.A.

Nr. 11 Dt. 08.03.2019
HQ 1

Arsim Janova
ud. Kryesues i Bordit të ZRrE

Ermal Koçi
Drejtor i Buxhetit, KEDS

08 March 2019

Lënda: Komentet e OSSh-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Vitin Relevant Tarifor 2019

I nderuar z. Janova,

Ky dokument përmbledh komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSh-së) për Raportin Konsultativ (RK) të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE-së) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Vitin Relevant Tarifor 2019, të publikuar më 22 shkurt 2019.

OSSH vlerëson mundësinë e dhënë për t'i ofruar komentet e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ (RK) të ZRrE-së dhe kërkon nga ZRrE-ja që të shqyrtojë me seriozitet qëndrimin e tij mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in e vitit 2019.

OSSH është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK dhe kundër-argumentet e ofruara në këtë raport.

Me respekt,




Ermal Koçi
Drejtor i Buxhetit



Komentet nga KEDS ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2019

I. Hyrje

Ky raport paraqet përgjigjet e KEDS-it ndaj Raportit Konsultativ (RK) për të Hyrat e Lejuara Maksimale për KEDS (Prill 2019 - Mars 2020) të publikuara më 22 shkurt 2019.

KEDS i licencuar si Operator i Sistemit të Shpërndarjes e vlerëson mundësinë për të dhënë inputet e tij në çështje të rëndësishme të ngritura nga ZRRE-ja në Raportin Konsultativ dhe kërkon që ZRRE-ja të konsideroj seriozisht qëndrimin e saj mbi çështjet e ngritura në këtë raport, përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in e vitit 2019. OSSH do të jap argumentet e veta për të gjitha çështjet për të cilat nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së, së bashku me tabelat mbështetëse dhe propozimet për përshtatje. Do të sigurohen edhe versionet elektronike të të gjitha tabelave, ashtu që ZRRE-ja mund t'i shfrytëzojë ato në punën e saj.

KEDS-i është në dispozicion për t'u takuar me ZRRE-në në çdo kohë për të diskutuar çështjet e ngritura në RK të ZRRE-së dhe kundër-argumentet e dhëna në këtë raport.

II. Bilanci i energjisë

Ne kemi vërejtur se ZRRE-ja ka përdorur të njëjtën metodologji të aplikuar vitin e kaluar për llogaritjen e Energjisë që pritet të plasohet në Distribucion (EED), por e cila nuk është në përputhje me metodologjinë e përdorur në Bilancin e Energjisë të aprovuar nga Rregullatori për vitin 2019. Respektivisht, qasja e ZRRE-së për kalkulimin e EED-së për qëllime tarifore është të mos e konsideroj nivelin e humbjeve mbi nivelin e lejuar nga ZRRE-ja gjatë kalkulimit të EED-së.

Ne jemi dakord që ZRRE-ja për qëllime të tarifave do të dhe duhet të përdor vetëm nivelin e lejuar të humbjeve për kalkulimin e kostos së humbjeve, por për të shmangur përshtatje të mëdha të humbjeve sa i përket vëllimeve (siç ndodhi në vitin 2017 dhe 2018), i cili do të rikthehet duke aplikuar edhe normën e interesit në vitin e ardhshëm, do të ishte me e drejtë që për qëllime të parashikimi të EED-së të përdoret qasja e duhur ashtu siç është aplikuar në bilancin e energjisë. Për më tepër, ZRRE-ja duhet të marrë në konsideratë edhe faktin se trendi i shitjeve tregon rritje prej 4-5 % në vit, e cila rezulton edhe në rritjen e EED-së. Ne pajtohemi se si rezultat i zvogëlimit të humbjeve, rritja e EED-së nuk mund të jetë në mënyrë lineare me rritjen e trendit të shitjeve, por të paktën duhet të jetë i afërt me atë të arritur në fund të vitit 2018 (5120 GWh).



OSSH-ja ka vënë re gjithashtu se shitjet e përdorura nga ZRRE-ja në RK kanë ndryshuar nga parashikimi i OSSH-së i përdorur në aplikimin e tij fillestar, dhe se alokimi i shitjeve në nivelet e tensionet të përdorura për OSSH-në dhe FSHU-së ndryshojnë. Marr parasysh faktin se konsumatorët e kyçur në nivelin 35 kV, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në Ligjin për Energji nuk do të rregullohen nga prilli i vitit 2019, i vetmi ndryshim mes shitjeve të OSSH-së dhe FSHU-së duhet të jenë konsumatorët e kyçur në nivelin 35 kV. Në këtë kuptim, OSSH-ja ka aplikuar në mënyrë të duhur shitjet e rishikuara, të përdorura nga ZRRE-ja në propozimin e vet për vitin tarifor 2019.

Duke marrë parasysh të përmendurat më lart, ne kërkojmë nga ZRRE-ja të përdor vlerën e pritshme të shitjeve dhe humbjeve gjatë llogaritjes së EED-së për vitin përkatës 2019, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Bilanci i Energjisë në nivelin e shpërndarjes	Njësia	Propozimi 2019	Komentet e KEDS 2019
Shitjet e pritura	GWh	3840	3772
Energjia e pa-faturuar për Veriun	GWh	259	259
Humbjet për veriun e Kosovës	%	5.13%	5.0%
Humbjet e lejuara	%	18.80%	18.8%
Humbjet e lejuara	GWh	949	965
Humbjet totale pa veriun e Kosovës	%	18.80%	21,47%
Humbjet totale pa veriun e Kosovës	%	949	1102
EED e pritur	GWh	5,048	5,133

III. Kostoja e humbjeve në OSSH

OSSH në parim pajtohet me mënyrën e llogaritjes së kostos së humbjeve nga ana e ZRRE-së, megjithatë për shkak të vërejtjeve të bëra në pjesën 'Bilanci i Energjisë' i shpjeguar më lartë, duhet të aplikohet niveli i prishëm i humbjeve dhe i EED-së.

ZRRE-ja në raportin e saj argumentoi se për llogaritjen e kostos së humbjeve ka përdorur një çmim të përbërë mesatar, i cili konsideron një çmim të rritur për norme të inflacionit për blerjet nga KEK-u dhe çmimin e importit si mesatare e përbërë nga çmimet aktuale të realizuara dhe ato të disponueshme në bursat energjetike.

OSSH-ja dëshiron të theksojë se çmimi mesatar aktual i arritur për importin gjatë vitit 2018 ishte 68.9 €/MWh i cili ndikoi që çmimi mesatar për blerjen e humbjeve në vitin 2018 të jetë 47.4 €/MWh në krahasim me 44 €/MWh të lejuar në vitin 2018, e cila rezultoi me një diferencë prej 3 milion euro që është financuar nga OSSH-ja gjatë vitit 2018 (vetëm për dallimin në çmim). Për më tepër, gjatë llogaritjes së çmimeve të pritshme që OSSH-ja ka bërë në aplikimin e saj duhet theksuar se këto çmime janë bazuar



në çmimet në dispozicion ne atë kohe, të parashikuara për vitin 2019 sipas kalkulimeve ore për orë, duke marrë parasysh edhe ngarkesat ndërkufitare dhe ngarkesat për shërbim (service fee) që duhet t'i paguhen tregtareve.

Një rillogaritje e çmimit të importit më 4 mars, rezulton me një çmim mesatar prej 72.58 €/MWh. Marr parasysh të lartë-thënat, OSSH-ja kërkon që ZRRE-së të aplikoj çmimin aktual të shkaktuar në vitin 2018 për volumet e parashikuar që do të blihen nga importet sipas llogaritjeve ore për orë.

Kalkulimet e tilla te aplikuar nga OSSH-ja rezultojnë me kostot e pritshme të humbjeve për vitin 2019 me rreth 43.32 milion euro, siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Njësia	ETR11 propozuar	KEDS Komentet
Norma e Interesit	%	7.49%	7.49%
LSSAt	%	18.8%	18.8%
REUEt	GWh	5,048.3	5,133.31
WHEAT	€/ MWh	42,97	44,88
LSSCt	€ m	40,78	43,32

Është e rëndësishme të theksohet se pasi që negociatat për çmimet nuk janë finalizuar ende në mes të OSSh-së dhe palëve të mundshme kontraktuese, çmimi i humbjeve mund të jetë i ndryshëm nga ai që konsiderohet nga ZRRE-ja, prandaj çdo ndryshim duhet të jetë subjekt i korrigjimit në procesin e ardhshëm të rishikimit të tarifave.

IV. Kostot e Operimit (OPEX)

Pavarësisht nga komentet tona të vazhdueshme që ZRRE-ja duhet të pasqyrojë kostot e duhura të përfshira në OPEX, ZRRE-ja vazhdon të zbatojë kostot qe janë parashikuar në vitin 2011, e për me tepër zbaton faktorin e efikasitetit prej 1.5%. Me poshtë do te pasqyrojmë argumentet dhe arsyetimet tona të cilat duhet të konsiderohen nga ZRRE dhe respektivisht të pasqyrohen drejtësisht shpenzimet operative.

IV.i Rritja e shpenzimeve te shërbimit

Rritja e vazhdueshme e numrit të konsumatorëve për çdo vit ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë gjatë viteve, gjë e cila për fat të keq nuk është duke u marrë në konsideratë nga ZRRE-ja. Siç kemi treguar në aplikimin tonë, edhe në qoftë se ne aplikojmë një faktor efikasiteti kostot e shërbimit për numër te konsumatorëve sërish rezultojnë me rritje, një fakt që ne kërkojmë të merret parasysh.



Duke marrë parasysh parametrat e ri të vendosur dhe problemet financiare që OSSH-ja po përballet nga viti i kaluar, zbatimi i faktorit të efikasitetit do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë tek punëtorët, sidomos duke pasur parasysh se faktori i efikasitetit është aplikuar edhe në linjat e pagave dhe mirëmbajtjes. Duhet të ritheksohet se me qëllim të kursimit të shpenzimeve, pjesa më e madhe e punës së mirëmbajtjes kryhet përmes punëtorëve të OSSH-së (të cilët përfshihen në linjat e pagave), andaj aplikimi i normës së efikasitetit në linjën e mirëmbajtjes automatikisht do të ndikojnë në punët e mirëmbajtjes, pasi aktualisht kostot e lejuara mbulojnë vetëm koston e çmimeve dhe materialeve. Meqë OSSH-ja nuk ka kontroll mbi çmimet e jashtme, të cilat janë rritur përgjatë viteve të kaluara, ne kërkojmë nga ZRRE-ja të marrë në konsideratë këtë fakt gjatë përcaktimit të OPEX për vitin 2019.

Në mënyrë të ngjashme, edhe shpenzimet e derivateve pritet të rriten sërish gjatë vitit 2019, marrë parasysh trendin e rritjes së vazhdueshme në dy vitet e fundit. Tabela në vazhdim tregon se shpenzimet për derivate për 1 km janë rritur mesatarisht 7% në dy vitet e fundit, pa i përfshirë në kalkulime edhe çmimet e kontraktuara për vitin 2019.

Viti	Total distance e automjeteve	Total përdorimi i derivateve	Përdorimi i derivateve për 100 km	Shpenzimet për përdorim te derivateve	Shpenzimet e derivateve për km	Ndryshimi ne %
2017	9,624,090 km	968,805 Lt	10.07 Lt	€ 831,652	€ 0.09	3%
2018	9,727,650 km	974,915 Lt	10.02 Lt	€ 939,403	€ 0.10	12%

Duhet theksuar gjithashtu se me miratimin e parametrave të reja për periudhën e dytë rregullative në fund të vitit 2018, OSSH-ja nuk ishte në gjendje të financonte investimet. Në këtë pikëpamje edhe linja që konsideron blerjen e automjeteve të reja është shtyrë, duke ndikuar më tej në rritjen e konsumit të derivateve dhe koston e mirëmbajtjes për automjetet, veçanërisht makineritë e rënda. Duhet gjithashtu të theksohet se çmimet për mirëmbajtjen e automjeteve kane shënuar rritje në dy vitet e fundit, duke rezultuar kështu me rritjen e shpenzimeve totale për mirëmbajtjet e rregullta dhe atyre emergjente. Në tabelën në vazhdim janë përmbledhur shpenzimet e rritura të mirëmbajtjeve të automjeteve gjatë dy viteve të fundit, si ato të rregullta ashtu edhe ato emergjente, dhe fatkeqësisht trendi i rritjes së çmimeve pritet të vazhdoj tutje edhe në vitin 2019.

Viti	Shpenzimet e Mirëmbajtjeve te Rregullta dhe te Parregullta	Ndryshimi ne %
2017	€ 422,856	10%
2018	€ 474,660	12%

Nga draft pasqyrat financiare të dorëzuara në ZRRE, mund të shihet qartësisht se shpenzimet operative ditore të OSSH-se gjatë vitit 2018 kanë shënuar rritje nga ato të vitit 2017 për 6%, pikërisht për shkak të arsyeve të dhëna më lartë. Prandaj, çfarëdo zvogëlim i OPEX-it, me aplikimin e normës së efikasitetit



vështirëson pozitën financiare të OSSH-së edhe me tej, në kohën kur OSSH tashmë po përballet me vështirësi financiare për shkak të mos-vendosjes së duhur të parametrave rregullative.

IV.ii Pagat

Gjatë rishikimit për periudhën e dytë rregullative, ZRRE ka aprovuar nivelin e pagave me të njëjtin nivel të aprovuar gjatë vitit 2017, me një rritje të vogël që reflekton ndryshimet në sektorin e energjisë dhe kërkesat qeveritare, sidoqoftë diferenca ndërmjet punëtorëve që punojnë në sektorin publik (KEK, KOSTT) dhe atyre që punojnë tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) janë ende të larta, prandaj nuk mund të themi se kemi reflektim të shpenzimeve aktuale. Për më tepër, ZRRE aplikon faktorin e efikasitetit edhe në linjën e pagave, duke ndikuar kështu drejtpërsëdrejti tek punëtorët.

Rritja e volumeve të punës dhe ndryshimet e përgjithshme në strukturën organizative të stafit po reflektojnë me rritje të numrit të inxhinierëve, që nënkupton rritje të shpenzimeve për punëtorë (paga) dhe pavarësisht uljes së numrit të punëtorëve fizik, ky ndryshim nuk është proporcional as sa i përket numrit të punëtorëve e as shpenzimeve.

Pagat më të larta në sektorin publik e ekspozojnë OSSH-në vazhdimisht ndaj kërcënimeve për humbjen e punëtorëve profesional, duke ndikuar kështu si në rrjedhën e punës ashtu edhe në kualitetin e punës.

Marr parasysh të lartë-thënat, kjo kërkesë për reflektim të drejtë të pagave duhet të trajtohet edhe ndaras dhe me përfshirjen e të gjitha palëve të interesit.

IV.iii. Komentet finale

Nëse marrim në konsideratë argumentet e arsyetuara më lartë, OSSH-ja kërkon nga rregullatori të aplikoj një rritje prej 3% nga OPEX-i i aprovuar në vitin 2018 dhe respektivisht të mos aplikohet faktori i efikasitetit.

Kjo do ta ndihmojë OSSH-në të rikthejë humbjet financiare dhe të vazhdojë me operime të qëndrueshme.

V. Komponentët tjera


Nga marsi 2017, OSSH-ja, si pjesë e sistemit balancues është përgjegjëse për çdo devijim të humbjeve të parashikuara, të cilat shpenzime nuk ishin parashikuar nga ZRRE-ja.

Duhet të konsiderohet se humbjet kryesisht ndodhin në çdo kohë kur ndodhin shitjet, madje edhe planifikimi i konsumit të shpërndarjes bëhet së bashku me konsumin e konsumatorëve, energjinë për



humbjet përkatëse dhe energjinë e prokuruar orë për orë. Të gjithë këta faktorë merren parasysh gjatë planifikimit të konsumit të shpërndarjes orë për orë. Për fat të keq, pasi që nuk ka asnjë parashikim të duhur të profilit të ngarkesës, aplikimi i koeficientit kur parashikohen humbjet në përgjithësi do të rezultojë me parashikimin e pasaktë të humbjeve.

Kostot e këtyre të hyrave nuk njihen nga rregullatori dhe një pjesë e këtyre të hyrave është edhe për shkak të humbjeve të tejkaluara, prandaj duke marrë parasysh të gjitha të hyrat, por duke mos njohur plotësisht kostot paraqitet një trajtim jo të drejtë, ashtu siç tregohet në figurën e mëposhtme:



Duhet të theksohet edhe një herë se jo balancat përfaqësojnë një sasi të energjisë të vënë në sistem, e cila ka një kosto (një pjesë e saj nuk njihet dhe nuk pranohet në tarifat), ndërsa askush në tregun lokal nuk e konsumon atë, përkatësisht konsumatorët nuk kanë pasur një kosto të energjisë së blerë e cila iu është bartur atyre, prandaj dhe këto të hyra nuk duhet t’iu kthehet atyre. Për më tepër, duke i trajtuar jo balancat si të hyra të parregulluara tregon se ZRRE-ja është e gatshme të marr vetëm balancat pozitive, por nëse jo balancat e tilla janë negative, nuk do të merret parasysh njohja e tyre.

Argumenti i dhënë nga Rregullatori që këto të hyra janë të hyra jo-tarifore nuk qëndron, pasi që bazuar në metodologjinë e përdorur për Furnizuesit e Shërbimit Universal, llogaritja e MAR-it përfshin të dyja, të hyrat jo-tarifore dhe ndaras i trajton jo balancat në llogaritjen e kostove me shumicë. Në këtë kuptim, **nuk ka bazë ligjore për heqjen e të ardhurave nga jo-balancat**, veçanërisht për shkak se bazuar në parimin e çmimeve asnjë e hyrë nuk duhet të merret parasysh nëse entitetit nuk i njihen dhe nuk i lejohen kostot të cilat i ngarkohen konsumatorët fundorë. Pjesa e të hyrave për koston e humbjeve rregullohen



vetëm për nivelin e lejuar të humbjeve. Jo-balancat përfaqësojnë vetëm kostot për aktivitetet tregtare dhe nuk janë pjesë e OSSH-së, andaj përderisa nuk i lejohen kostot, nuk duhet të zbriten të hyrat nga këto jo-balance.

Energjia për të cilën OSSh ka marrë kompensim për shërbimet e jo-balanceve është një kosto që nuk është e rregulluar. Siç e theksuam më lartë këto kosto nuk barten tek konsumatorët fundorë dhe kompensimi në formën e një jo-balanceje nuk rrjedh nga Baza e Rregulluar e Aseteve.

V.i. Trajtimi i jo balancës për vitin 2017

Viti 2017 përfaqëson vitin e parë të trajtimit të jo balancave, dhe pasi nuk kishte asnjë formulë në Rregullën e Çmimeve të OSSH-së, kur shpenzimet e tilla janë kërkuar që të paraqiten, OSSh-ja i ka vënë ato në llogaritjen e kostove të energjisë, ngjashëm me aplikimin e bërë në FSHU.

Ky trajtim ka ulur çmimin mesatar të humbjeve nga 46 € / MWh në 44 € / MWh, për faktin se jo balancat ishin pozitive, prandaj ato janë përfshirë si zbritje gjate llogaritjes përfundimtare të kostove, siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Përdorur nga Rregullatori		Pa përfshirjen e jo-balancave	
	MWh	euro	MWh	euro
Blerjet nga KEK-u	381665	13510927	381665	13510927
Blerjet nga importi	315260	18532083	315260	18532083
Jo balancat		- 1.424.265		
Totali	696925	30618746	696925	32043011
Çmimi mesatar		43,93		45,98

Përveç përdorimit të çmimin mesatar të zbritur për vlerat e jo balancës (siç u parashikuar fillimisht në kohën e aplikimit), ZRRE-ja gjatë llogaritjes së MAR-it final ka zvogëluar të hyrat e parregulluara në formë të plotë siç janë paraqitura në pasqyrat financiare, përfshirë të hyrat për jo balancat , **duke zvogëluar MAR-in përfundimtar të OSSH-së dy herë për të njëjtat të hyra.**

Të hyrat e konsideruara nga ZRRE-ja janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	sasia
Pëlqimet Elektroenergjetike	1924
Shërbime të tjera	1668
Të Hyra të tjera	924
Qiraja	100
Te hyrat nga Jo balanca	1519
Norma e Interesit	14.87%
Total me normë interesi	7047



Pa diskutuar dhe argumentuar edhe një herë nëse jo balancat e tilla duhet të trajtohen si të hyra, gjatë vitit 2018 ZRRE-ja ka zvogëluar dy herë të hyrat nga jo balancat: një herë në llogaritjen e çmimit mesatar të humbjeve dhe herën e dytë në të hyrat e parregulluara, prandaj, në këtë aplikim OSSH-ja kërkon një aplikohet korrigjim.

Duke pasur parasysh qasjen e përdorur nga ZRRE-ja në propozimin tyre për vitin 2019, ne kemi aplikuar këtë korrigjim në çmimin e humbjeve. Në këtë kuptim, përshtatjet për koston e humbjeve të lejuara për vitin 2018 duhet të ketë qenë 39.44 milionë € në vend të 37.78 milion €, siç është treguar në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	2017 Propozuar	Përshtatjet e Aplikuara	Aplikimi i saktë
It	14.87%	14.87%	14.87%
LSSAt	18.13%	18.13%	18.13%
REUEt	3,962.1	4,731.3	4,731.3
WHEAt	35,43	44,04	45,98
LSSCat-1		37,78	39,44
LSSCft-1	25.5		
LSSCt	29,72		
		9.26	11.17
Korrigjim			1.91

Për qëllime sqarimi, këto llogaritje përfshijnë periudhën prill-dhjetor, siç janë aplikuar nga ZRRE gjatë procesit të përcaktimit të MAR në vitin 2018, sepse për tre muajt e parë (janar-mars) blerjet për mbulimin e nevojës së sistemit (humbjet e OST dhe OSSH) janë kryer nga Furnizuesi i Shërbimeve Publike prandaj dhe janë të përfshira në MAR-in e Furnizuesit me Shërbim Universal. Në këtë pikëpamje në këtë aplikim, OSSH-ja aplikon korrigjimin prej 1.91 milion € duke aplikuar edhe normën e interesit dhe kërkon nga rregullatori të aplikoj këtë korrigjim.

Megjithatë, duke marrë parasysh argumentet e dhëna në pjesën e mësipërme dhe se ZRRE nuk ka bazë ligjore për të zbritur këto të ardhura, OSSH kërkon gjithashtu që edhe diferencën prej 1.5 milion € të zbritur nga të ardhurat e parregulluara t'i kthehet OSSH duke aplikuar normën e interesi.

Të dyja këto përshtatje janë konsideruar në këtë raport, gjatë llogaritjes së MAR-it përfundimtar.

V.ii. Të hyrat e parregulluara

ZRRE-ja ngjashëm me aplikimin e vitit të kaluar ka zvogëluar gjithsej të hyrat e parregulluara siç janë paraqitur në pasqyrat financiare. Siç është argumentuar më parë, në raportet financiare paraqiten të



hyrat që përdoren për qëllime të kontabilitetit, por jo të gjitha këto të hyra paraqesin qarkullim parash (cash-item). Duhet theksuar se zërat "linjat e zhvlerësimit" (Impairment lines) të paraqitura në raportin financiar si të hyra për qëllime të kontabilitetit, nuk duhet të konsiderohen nga Rregullatori si të hyra të parregulluara, pasi këto linja nuk paraqesin të hyrat aktuale, përkatësisht asnjë faturë nuk është lëshuar dhe respektivisht asnjë para e gatshme nuk ka qarkulluar. OSSH-ja ka paraqitur këto vlera në detaje në formatin Excel te dorëzuar ne ZRRE.

Për më tepër, ashtu siç është argumentuar sa me sipër, OSSH në kalkulimet përfundimtare ka zbritur edhe të hyrat nga jo balancat nga të hyrat e parregulluara që figurojnë në pasqyrat financiare.

V.iii. Përshtatjet për KREV

Në përgjithësi pajtohem me metodologjinë e ZRRE-së për llogaritjen e KREV-it, megjithatë për shkak të korigjimeve të lartpërmendura, në kalkulimin përfundimtar të KREV-it duhet të pasqyrohen edhe këto përshtatje.



VI. Të Hyrat e lejuara maksimale për OSSH-në

Tabela e mëposhtme paraqet MAR-in përfundimtar për OSSH-në për vitin 2019, pas marrjes në konsideratë të gjitha përshtatjet e nevojshme siç shpjegohet në seksionet e mësipërme.

OSSH MAR		Propozimi ZRRE-se	i Komentet KEDS
It	%	7.49%	7.49%
Kostot Operative dhe të mirëmbajtjes (OPMct)			
$OPMct = OPMct - 1 * (1 + CPIt - 1) * (1 - Et) * (1 - Pt)$	€ m	26.18	27.42
Zhvlerësimi i lejuar (DEPct)			
$DEPct = DEPct - 1 * (1 + CPIt - 1) * (1 - Pt)$	€ m	14.65	14.65
Kthimi i Lejuar (RTNct)			
$RTNct = RTNct - 1 * (1 + CPIt - 1) * (1 - Pt)$	€ m	13.59	13.59
OS dhe OT Detyrimi për KOSTT			
		1.13	1.13
Humbjet e lejuara (LSSct)			
LSSAt	%	18.80%	18.80%
REUet	GWh	5.048.3	5,133.31
WHEAt	€ / MWh	42.97	44.88
LSAct-1			
LSSct		40.78	43.32
përshtatjet			
Të hyrat e parregulluara	€ m	-3.50	-3.50
Përshtatjet (2017 & PR1)		-1.50	-1.50
KREV			
KREV	€ m	4.98	13.26
MAR			
$Mart = OPMct + DEPct + RTNct + LSSct + LICct + KREvt$	€ m	96,44	108.37

OSSH-ja beson se MAR-i prej 108.37 milionë € paraqet kostot reale të rrjetit të shpërndarjes, dhe është në dispozicion për t'u takuar me ZRRE-ne në çdo kohë për të diskutuar në hollësi çështjet e ngritura në këtë raport.